



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 nëntor 2013
Nr.ref.: RK491/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI67/13

Parashtrues

Z. Shaqir Prevetica

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 228/2012 të 12 marsit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shaqir Prevetica, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 228/2012, të 12 marsit 2013 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i kontestuar), të cilin e ka pranuar parashtruesi më 25 prill 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kérkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të kontestuar, i cili supozohet t'i ketë shkelur parashtruesit të drejtën për punë të garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121, i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi kérkesën në Gjykatë.
6. Më 27 maj 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtyues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 19 qershor 2013, Gjkata njoftoi parashtruesin e kérkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kérkesës.
8. Më 12 shtator 2013, Kolegji shqyrtyues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit rapportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e fakteve

9. Parashtruesi ka punuar në kompaninë hoteliere turistike “Kosova”(në tekstin e mëtejmë: KHT “Kosova”) derisa ai është dërguar në asistencë sociale.
10. Më 12 dhjetor 2001, Bordi i drejtorëve i KHT “Kosova” (Vendimi nr. 117), vendosi që nga 1 janari 2002, parashtruesin ta dërgojë në asistencë sociale me pagesë, duke ia mundësuar pranimin e të ardhurave personale prej 70% (shtatëdhjetë për qind) nga paga mesatare e punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje hoteliere. Në atë Vendim thuhet se: *“këtë status kompania ia siguron nga mjetet e veta derisa të funksionojë institucionin përkatës shtetëror përrregullimin përfundimtar të pensionimit të ligjshëm të tij”*.
11. Më 10 shtator 2002, Gjkata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi C. nr. 46/02) e hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të paafatshme.

12. Më 1 shkurt 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 592/2002) prishi Aktvendimin, të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe lëndën ia ktheu së njëjtës gjykatë në rigjykim.
13. Më 6 qershor 2005, Gjykata Komunale (Aktvendimi C. nr. 130/05), hodhi poshtë padinë e parashtruesit si të paafatshme.
14. Më 21 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut (Aktvendimi Ac. nr. 56/2006), prishi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe ia ktheu lëndën gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
15. Më 1 prill 2009, Gjykata Komunale (Aktvendimi Cl. nr. 05/2008) ndërpree procedurën e gjykimit të mëtejmë të çështjes kontestimore, “për shkak se KHT “Kosova” ish-“Sloga” në Prishtinë, është privatizuar dhe se likuidimi i ndërmarrjes së lartcekur ka hyrë në fuqi më 11 prill 2007.”
16. Më 20 korrik 2009, Gjykata e Qarkut (Aktvendimi Ac. nr. 1178/2009), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale duke hedhur poshtë padinë si të paafatshme.
17. Më 12 mars 2013, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 228/2012) refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut. Gjykata Supreme vendimin e saj e arsyeton si në vijim:

“Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore kur ka gjetur se anesa është e pasafatshme. Me dispozitën e nenit 208 lidhur me nenin 176 par. 1 të LPK-së, është paraparë se kundër aktvendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktvendimit, ndërsa nen 186 par. 2 i ligjit të cekur, parasheh se anesa është e pasafatshme po qe se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj. I autorizuari i paditësit, avokati Ali Qosja, kopjen e Aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, CI. nr. 5/2008, të 1 prillit 2009, e ka pranuar më 2 prill 2009, ndërsa paditësi ankesën e ka ushtruar më 30 qershor 2009, d.m.th. anesa është paraqitur pas afatit ligjor të paraparë me dispozitën e nenit 176 par. 1 lidhur me nenin 208 të LPK-së, se me të drejtë e kanë vlerësuar gjykatat e instancës më të ulët, të cilat kanë dhënë arsyë të mjaftueshme në aktvendimet e tyre, e të cilat i mbështet edhe kjo gjykatë e revizionit, si të drejta e të bazuara me ligj”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pohon se vendimet e gjykatave të rregullta ia kanë shkelur atij të drejtën e punës të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.
19. Parashtruesi kërkon nga Gjykata dëmshpërblim për kohën e humbur, duke përfshirë periudhën kohore prej 1 janarit 2002 gjer më sot për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve së punës nga punëmarrësi.

20. Për më tepër, parashtruesi i ankohet ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta përkitazi me: a) *hedhjen poshtë të padisë së tij si të pasafatshme; dhe b) konstatimet e gjykatave lidhur me pohimet e ish-Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, “se KHT “Kosova” ish-“Sloga” në Prishtinë është privatizuar dhe se likuidimi i ndërmarrjes së lartcekur ka hyrë në fuqi më 11 prill 2007”, duke theksuar se deri më 25 prill 2013, likuidimi i ndërmarrjes në fjalë nuk ka filluar për shkak se njëzetpërqindëshi (20%) ndaj punëtorëve të ndërmarrjes në fjalë ende nuk është realizuar.*

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7, i cili përcakton:

7.“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

23. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

24. Gjykata vëren se Parashtruesi është person fizik, ka ndjekur procedurat përgjatë instancave në dispozicion dhe ka parashtruar kërkesën brenda afatit të paraparë prej katër muajsh.

25. Prandaj Gjykata konsideron se parashtruesi është një palë e autorizuar, ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj dhe ka parashtruar kërkesën me kohë.

26. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu duhet ti referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojojë”.

27. Për më tepër, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) dhe rregullit 36 (2) a) dhe b) të Rregullores së punës, që parashev:

36 (1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) Kërkesa është qartazi e bazuar.

36 (2) Gjykata do tē refuzojë një kérkesë si qartazi tē pabazuar, nëse bindet se:

*a) Kérkesa nuk arsyetohet *prima facie*;*

b) Faktet e paraqitura në asnje mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një tē drejte kushtetuese”.

28. Gjykata vëren se parashtruesi pretendon shkeljen e tē drejtës së tij për punë tē garantuar me nenin 49 tē Kushtetutës.
29. Gjykata gjithashtu thekson se, duke u përgjigjur pretendimeve tē bëra nga parashtruesi, Gjykata Supreme “ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë tē drejtë dispozitat e procedurës kontestimore kur ka gjetur se ankesa ishte e paafatshme.”
30. Gjykata konsideron se vendimi i Gjykatës Supreme është i qartë dhe i arsyetuar mirë. Parashtruesi nuk ka qartësuar saktësisht si dhe pse vendimi i Gjykatës Supreme ka shkelur tē drejtën e tij për punë.
31. Në fakt, parashtruesi nuk ka sqaruar dhe dëshmuar konkretisht se ankesa e tij është parashtruar në kohën e duhur dhe rrjedhimisht ka pasur shkelje tē së drejtës së tij për punë.
32. Gjykata vëren se, parashtruesi i kérkesës ankohet vetëm ndaj vendimeve të gjykatave tē rregullta, përkizati me konstatimin se ankesa nuk ishte parashtruar brenda afatit ligjor siç kérkohej me dispozitat e ligjit tē aplikueshëm.
33. Gjykata rikujton se nuk është detyrë e saj që tē vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve tē dhëna nga gjykatat e rregullta, përveç nëse vendimet e tillë janë nxjerrë në mënyrë arbitrale dhe tē paarsyeshme.
34. Detyra e Gjykatës është që tē vlerësoje nëse procedurat, në tërësinë e tyre, kanë qenë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Pra, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave tē rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse tē së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për tē Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
35. Në rastin konkret, parashtruesi nuk ka paraqitur asnje provë *prima facie* që tregon se shkeljet e supozuara tē përmendura në kérkesë, përbejnë shkelje tē tē drejtave kushtetuese (Shih, Vanek kundër Republikës Slovake, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kérkesës, nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
36. Prandaj, Gjykata nuk mund tē konsiderojë se procedurat përkatëse tē zhvilluara në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë tē padrejta apo arbitrale (Shih, *mutatis mutandis*, Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kérkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

37. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përbush të gjitha kriteret e pranueshmërisë, dhe prandaj, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) a) dhe b) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) a) dhe b), si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 shtator 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

